



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Përfshirja e fëmijëve në institucione parashkollore

NUMËR:6/2008

DATË: 3.03.2008

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 2.3 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (më poshtë MASHT) nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim administrativ ka për qëllim të sigurojë mundësinë e përfshirjes së fëmijëve të grup-moshave të ndryshme në edukimin parashkollor.

Neni 2

Mosha fillestare

1. Edukimi parashkollor që përfshin fëmijët prej moshës 6 muaj dhe do të organizohet nga institucionet të cilat kanë kushte dhe kritere për këtë moshë.
2. Edukimi parashkollor përfshin fëmijët nga mosha 9 muaj deri në fillim të klasës së parë.
 - a) në çerdhe përfshihen fëmijët nga mosha 6, 9 muaj deri në 3 vjet, ndërsa
 - b) në kopshte përfshihen fëmijët nga mosha 3-6 vjet.

Neni 3

Përfshirja e fëmijëve në institucione parashkollore

1. Përfshirja e fëmijëve në grupe edukative sipas grup-moshave:

	Optimal	Minimal	Maksimal
6, respektivisht 9 muaj -1 vj	8	6	10
1 - 2 vj	12	10	14
2 – 3 vj	14	12	16
3 – 4 vj.....	20	18	22
4 – 5 vj	22	20	24
5 – 6 vj	24	22	26
- 1 – 3 vj	10	8	12
- 3 – 6 vj	20	18	23

2. Në të gjitha grupet edukative duhet të punojnë nga 2 edukator/e.

Neni 4

Përfshirja e fëmijëve në paralele parafillore

1. Për grupet përgatitore (parafillore) optimale (26), minimale (15), maksimale (28).
2. Në rast të kërkesave të mëdha dhe në mungesë të kapacitetit të objekteve, mund të rritet numri me lejen e DKA-së.
3. Nëse kapaciteti i pranimit të fëmijëve është i madh në raport me numrin e kërkesave për vendosjen e tyre, mund të formohet grupi edukativ me lejen e DKA-së.

Neni 5

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta

1. Çdo fëmijë me nevoja të veçanta ka të drejtë të përfshihet në njërin prej programeve të edukimit, gjatë periudhës parashkollore, andaj duhet të sigurohen mjete për realizimin e të drejtave të tyre.
2. Në institucionet parashkollore me programe tërëditore e gjysmëditore mund të përfshihen fëmijët me dëmtime të lehta.
3. Fëmijët me dëmtime të rënda mund të përfshihen në institucionet parashkollore nëse institucioni e ka të siguruar kuadrin adekuat profesional dhe kushte tjera të nevojshme, varësisht nga lloji i dëmtimit.

4. Në një grup edukativ me programet 10-orëshe (tërëditor), përgatitore (parafillore) apo të shkurtra, mund të jenë të përfshirë dy fëmijë me nevoja të veçanta .
5. Numri i fëmijëve me program primar (tërëditor) me dy fëmijë me nevoja të veçanta, të zvogëlohet për 20% në raport me grupin e përcaktuar me normativ të paraparë me nenin 3 paragrafi 1.
6. Nëse nuk ka mundësi për zvogëlim, të kompensohet me një asistente.
7. Koha e qëndrimit të fëmijëve me nevoja të veçanta caktohet në bazë të dëmtimit të tij dhe mundësisë, se sa fëmijët janë në gjendje të përballojnë regjimin ditor të institucionit parashkollor dhe caktohet nga ekipi multidisiplinor.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga ministri.

Enver Hoxhaj, ministër